



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



PLANI PËR MIRËMBAJTJEN E HAPËSIRAVE TË HAPURA PUBLIKE NË KOMUNËN E JUNIKUT

Junik, 2016

Përmbajtja:

1. Hyrje	3
1.1. Profili i Komunës	3
1.2 Funksionet e HHP	5
1.2 Fushëveprimi i planit të mirëmbajtjes së HHP	5
Definimi i HHP të cilat përfshihen ne Planin e Mirëmbajtjes.....	6
1.3 Parimet Udheheqese	7
1.4 Dokumentet Referuese	7
Korniza ligjore	7
Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2014-2018,.....	8
2. Situata aktuale dhe analiza Hapsirave të Hapura Publike	9
2.1 Gjendja e tanishme e HHP	9
Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP	9
Sipërfaqet e tanishme të HHP në Komunën e Junikut	10
Kualiteti i HHP	10
Shfrytëzimi i HHP	11
2.2 Kontratat aktuale për menaxhimin e HHP	11
2.3 Shpenzimet operative për mirëmbajtjen e HP në tre vitet e kaluara	12
Lista e projekteve investive me prioritet për periudhën 2016-2020(HHP Ekzistuese)... Error! Bookmark not defined.	
2.4 Te dhena grafike dhe tabelare mbi HHP ekzistuese	14
a) Të dhënat grafike	14
b).Të dhënat tabelare	14
2.5 Analiza e aktiviteteve të mirëmbajtjes për fushat e mirëmbajtjes	15
a. Aktivitetet e pastrimit	15
b. Aktivitetet e hortikultures.....	15
c. Aktivitetet e mirëmbajtjes e ambientit të ndërtuar	15
3. Vizioni, Objektivat dhe Strategjia mbi HP	15
3.1 Vizioni i komunes mbi HHP	15
3.2 Synimet dhe objektivat	16
4. Planin financiar.....	16
4.1 Buxheti i nevojshëm(përsëritës)	16

5. Ndërgjegjësimi publik	16
5.1 Strategjia komunale për aktivitetet me komunitetin	16
1. Ndërgjegjësimi për mejdisin nëpërmjet edukimit	16
2. Ndërgjegjësimi nepermjet fushatave Mediale.....	17
3. Ndërgjegjësimi nëpërmjet kampanjave	17
Aktivitetet	17
Stimulimi i "Lokalitetit më të mirëmbajtur"	17
6. Monitorimi dhe rishikimi	18
Plotësimi dhe revidimi i PMHHP	18
7. Plani i Veprimit.....	21
Veprimi 1: Caktimi i zyrtarit për mjedis	21
Veprimi 2: Promovimi i HHP-Pergatitja e broshurave dhe organizimi i prezantimeve.....	21
Veprimi 3: Organizimi i aktiviteteve me komunitetin.....	21
Veprimi 3: Pergatitja e specifikacioneve teknike për HHP.....	21
Veprimi 4: Përgatitja e projekteve kryesore për HHP te reja	21
ANEKSET:.....	23
Plani Financiar.....	24
Plani Investiv.....	32

Juniku është komunë partnere në programin DEMOS, i financuar nga Qeveria Zvicerane dhe implementohet nga Helvetas Sëiss Intercooperation, i cili është i orientuar në mbështetje të krijimit dhe mirëmbajtjes së HP, vlerësimit, planifikimit, monitorimit të shërbimeve, zbatimit dhe ndërgjegjësimit publik.

1. Hyrje

1.1. Profili i Komunës

Komuna e Junikut gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës në veri-perëndim të luginës së Dukagjinit. Ajo kufizohet me komnat e Deçanit dhe Gjakovës si dhe nga Republika e Shqipërisë dhe e Malit të Zi. Komuna ka një sipërfaqe prej 77,77 km² prej të cilave zona urbane e qytetit të Junikut është 520 ha (5,2 km²). Zona urbane është vendosur në një lartësi mbidetare prej 450 m deri 600 m.

Komuna e Junikut, përveç qytetit të Junikut, përbëhet nga dy fshatra të braktisur në masë të madhe: Jasiq dhe Gjocaj. Për më tepër, Juniku është i rrethuar nga vargmalet e Bjeshkëve të Nemuna të cilat

ofrojnë një mundësi ideale për zhvillimin e turizmit malor me peizazh piktoresk - të pasur me florë dhe faunë, masivë të kanioneve piktoreske dhe kullotat shkëmbore në majat më të larta në Kosovë, majat e Bjeshkëve të Nemuna.

Juniku ka klimë kontinentale me karakteristika mesdhetare. Temperatura mesatare në muajin korrik është +21 °C, kurse në janar -11 °C. Reshjet mesatare vjetore sillen rreth 670 mm.

Sipas vlerësimit aktual të PZHK-së, Komuna e Junikut ka rreth 9600 banorë dhe rreth 770 ekonomi familjare. Megjithatë, numri përfshin edhe banorët në diasporë. Numri i banorëve aktual është 6078, 50% e të cilëve është nën moshën 26 vjeçare. Rreth 12.5% e tyre konsiderohet se jetojnë në varfëri. E gjithë popullsia është shqiptare.

Aktualisht fshatrat Jasiq dhe Gjocaj janë të pabanueshme për shkak të pranisë së minave tokësore. Në të dy fshatrat së bashku banojnë më pak se 10 familje dhe praktikisht e gjithë popullsia e komunës është e përqendruar në qytetin e Junikut. Duhet të theksohet se ekziston ndërtimi i shpërndarë në zonën malore. Kryesisht ka shtëpi të dyta për pushim/kullosa/aktivitetet sezonale në zonën malore të Bjeshkëve të Nemuna duke shkaktuar vështirësi të konsiderueshme në menaxhimin e mbeturinave në zonat jashtë qendrës së qytetit.

Rëndësia e HHP në procesin e planifikimit

Plani i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike është plan strategjik nga fusha e Mjedisit dhe ka për qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e nevojave për një mjedis më të mirë për të gjithë. Rritja e shkallës së popullsisë, paraqet edhe nevojën për zgjerimin e hapësirave publike, rregullimin si dhe mirëmbajtjen e tyre në harmoni me numrin e banorëve.

Hartimi i planit të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike nuk mund të kuptohet vetëm si një objektiv i thjeshtë, por si prioritet.

Planet e mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike kanë një rëndësi shumë të madhe sepse mbështeten në planet aktuale të zhvillimeve komunale, mirëpo janë shumë më të detajuar dhe më specifike në fushën e mjedisit në përgjithësi.

Qëllimi i planit të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mjedisor me qëllim që të krijojnë:

- *Hapësira gjelbëruese të mjaftueshme për të gjithë;*
- *Përmirësimin e shkallës së mirëmbajtjes;*
- *Zvogëlimin e ndotjes së ambientit;*
- *Planifikimin e investimeve për rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave ekzistuese si dhe zgjerimin e tyre në të ardhmen;*

1.2 Funksionet e HHP

Si hapësira të hapura publike i referohemi hapësirave me mundësi qasje nga publiku të cilat janë të destinuara për aktivitete formale, joformale, aktivitete rikrijuese, kulturore dhe funksione të tjera për komunitetin. Hapësirat e hapura publike, si asete komunale, promovojnë komunitete të shëndetshme.

- 1) **Përjetim i natyrës:** një mundësi për qytetarët që të përjetojnë mjediset e pasura dhe natyrore, arkeologjike, etj.
- 2) **Rekreacion:** ofrim i mundësive të llojllojshme për rekreacion në mjedise natyrore; ecje, vrapim, çiklizëm, tubime shoqërore, ngjarje kulturore.
- 3) **Edukim:** HP mund të shërbejnë edhe si klasa natyrore me mundësi mësimi dhe hulumtimi me nxënës dhe fëmijë të grupmohave të ndryshme.
- 4) **Projektim urban:** mjediset përgjatë HP karakterizohen me kufizime në zhvillimet ndërtimore dhe ofrojnë peizazhe dhe vizura të mira, definojnë kufijtë urban, si dhe dekurajojnë zgjerimet e pakontrolluara urbane.
- 5) **Krijimi i trashëgimisë:** ruajtja e tipareve të rëndësishme të mjedisit natyror të Junikut është prioritet i lartë për qytetarët dhe për ambiciet programore lidhur me shtretërit e lumenjve, korridoret e gjelbërta, ato hekurudhore, rrugore, etj.
- 6) **Organizime kulturore, edukim i publikut për ruajtjen e natyrës, ambientit dhe ngritjen e ndërgjegjes qytetare.**
- 7) **Funksionet rregulluese mikroklimatike, ruajtja e llojllojshmërisë së florës dhe faunës,** balancim i CO₂, motivim dhe inspirim për kulturë, art, etj.

Bartës i projektit është Komuna e Junikut, respektivisht Grupi Drejtues. Hartues i planit për Mirëmbajtjen e HHP dhe të Planit Investiv është Komuna e Junikut respektivisht grupi punues i mbështetur nga DEMOS.

Përshkrimi i procesit të hartimit të dokumentit

Në kuadër të projektit DEMOS, të financuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation, Komuna e Junikut është bërë një nga Komunat partnere, që hartimin e planit të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike e ka marrë me prioritet me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve. **Kryetari i Komunës z. Agron Kuçi, me Vendimin Nr. 01/ 24 të datës: 27.05.2015,** formoj grupin drejtues dhe grupit punues, për hartimin e Planit për Mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në Komunën e Junikut. Hartues të planit për HHP është Grupi punues ne mbështetje nga ekspertet e projektit DEMOS. Përfshirja e qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në hartimin e planit të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike është ndër principet themelore. Përfshirja dhe mendimet e tyre janë kontribut i rëndësishëm, *sepse ndërlidhet me nevojat e banorëve, organizimin e hapësirave gjelbëruese në qytet dhe fshatra, si dhe me kualitetin e jetës*

1.2 Fushëveprimi i planit të mirëmbajtjes së HHP

Plani i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike është plan strategjik nga fusha e Mjedisit dhe ka për qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e nevojave për një mjedis më të mirë për të gjithë. Rritja e

shkallës së popullsisë, paraqet edhe nevojën për zgjerimin e hapësirave publike, rregullimin si dhe mirëmbajtjen e tyre në harmoni me numrin e banorëve.

Hartimi i planit të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike nuk mund të kuptohet vetëm si një objektiv i thjeshtë, por si prioritet.

Planet e mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike kanë një rëndësi shumë të madhe sepse mbështeten në planet aktuale të zhvillimeve komunale, mirëpo janë shumë më të detajuar dhe më specifike në fushën e mjedisit në përgjithësi.

Qëllimi i planit të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mjedisor me qëllim që të krijojnë:

- *Hapësira gjelbëruese të mjaftueshme për të gjithë;*
- *Përmirësimin e shkallës së mirëmbajtjes;*
- *Zvogëlimin e ndotjes së ambientit;*
- *Planifikimin e investimeve për rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave ekzistuese si dhe zgjerimin e tyre në të ardhmen;*

Definimi i HHP të cilat përfshihen ne Planin e Mirëmbajtjes

Plani i mirëmbajtjes dhe investiv për periudhën është hartuar për periudhën afatmesme. Ne periudhën e parë të zbatimit është vendosur të inkuadrohen hapësirat si ne vijim:

Parqet	Varrezat	Parkingu
1 Moronica	1 Kompleksi i Varrezave	1 Parkingu prapa Obj. komunës
2 Rreth lumit Erenik		
3 Para Kuvendit Komunal		
4 Rrethrrrotullimi te Qendra e Qytetit		
5 Këndi i Lodrave		

Në rishikim plani do të përfshijë hapësirat të tjera të hapura publike varësisht nga nevojat/kërkesat dhe mundësitë buxhetore.

Varësisht nga përmbytja e hapësirave publike janë evidentuar fushat kryesore sa i përket aktiviteteve të nevojshme për mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike

Bazuar në Inventarizimin dhe analizimin e frekuencës së shfrytëzimit identifikohen HHP-të me shkallë të prioritetit të mirëmbajtjes dhe të investimeve. Inventarizimi është bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria për Urbanizëm duke shfrytëzuar softuer-in Q GIS

1.3 Parimet udhëheqëse

Komuna e Junikut ka të miratuar *Planin Zhvillimor Komunal*, *Planin Zhvillimor Urban*, si dhe *Planet Rregulluese Urbane* për Lagjet: “Qendër”, “Gacaferr-Pepsh” dhe “Krasniq - Bajraktar”.

për qytetin e Junikut. Në këto dokumente trajtimi i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike është trajtuar shumë pak në përgjithësi. Në kuadër të këtyre planeve janë trajtuar në masë më të madhe vend ndaljet e autobusëve dhe parkingjet për lokalitete të ndryshme. Në vijim janë paraqitur disa nga objektivat komunale të cilat janë paraparë në kuadër të këtyre planeve të cilat e trajtojnë hapësirën në përgjithësi.

1.4 Dokumentet referuese

Korniza ligjore

Plani i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike për komunën e Juniks, është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve së Juniks, sepse ndërlidhet me nevojat e banorëve, organizimin e hapësirave gjelbëruese në qytete dhe fshatra, si dhe me kualitetin e jetës.

Plani i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike për komunën e Junikut bazohet në kornizën ligjore në fuqi në Kosovë, si dhe parimet dhe konventat ndërkombëtare të cilat janë të ndërlidhura me mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike, si:

- Rregullores Komunale për Mirëmbajtjen e Pastërtisë në Territorin e Komunës së Junikut, datë: 28.08.2011
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale;
- Ligji për Planifikim Hapësinor
- Planin Zhvillimor Komunal 2009-2020;
- Planet Rregullues Urban (njësia “Qendër”, “Gacafer dhe Pepsh”, “Krasniq dhe Bajraktar”);
- Planin Zhvillimor Urban 2009-2020
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2014-2018;
- Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2016-2018;
- Planin Lokal i Veprimit në Mjedis .

Rregullores Komunale për Mirëmbajtjen e Pastërtisë në Territorin e Komunës së Junikut, qëllim primar i kësaj rregullore është përmirësimi i kushteve jetësore të qytetarëve, rregulli, qetësia dhe rendi

komunal, pamja sa më pastër e qytetit dhe vendbanimeve tjera mbrojtja e ambientit jetësor si dhe mirëmbajtja dhe shfrytëzimi sa më racional i objekteve publike dhe institucionale. Me këtë rregullore synohet të përcaktohen kushtet e përgjithshme për kryerjen e veprimtarive komunale, mirëmbajtja dhe mbajtja e higjienës në hapësirat publike si dhe të caktohen detyrat dhe obligimet e qytetarëve, ekonomive familjare, bashkësive të ndryshme, shoqatave, bizneseve, ndërmarrjeve, institucioneve, organeve të administratës lokale si dhe subjekteve të tjera për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës publike në qytetin e Junikut e në veçanti të caktohen kushtet minimale për mbajtjen e pastërtisë e higjienës në vendbanime periferike dhe në tërë territorin e Komunës së Junikut.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale përshkruan bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse. Në kuadër të Ligjit për vetëqeverisje lokale, janë caktuar të drejtat në nivel lokal, si e drejta për:

- zhvillimin lokal ekonomik;
- planifikimin urban dhe rural;
- shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; mbrojtjen e mjedisit lokal; janë kompetencat vetanake, të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, këto kompetenca janë përcaktuar me nenin 17 të ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Ligji për Planifikim Hapësinor, ka për qëllim rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban. Në kuadër të këtij ligji, planifikimi hapësinor duhet ti respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të Kosovës dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm, po ashtu duhet ti përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet ti përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet.

Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, parashikohet që ekspertiza profesionale të integrohet në sistemin e planifikimit duke e themeluar komisionin e ekspertëve të planifikimit (në nivelin lokal). Në Kosovë ekzistojnë dy nivele të planifikimit (kombëtare dhe lokale) dhe llojet e planeve janë: plani hapësinor i Kosovës, planet hapësinore për zona të posaçme, planet zhvillimore komunale (PZHK), planet për zhvillim urban, planet rregulluese urbane.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit cakton, shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar. Përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2014-2018

Korniza Afatmesme Buxhetore për Komunën e Junikut, është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve KASH të Kosovës, është e ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore 2016/2018 të dhënat nga MF-i përmes Qarkores Buxhetore 2016/01.

Korniza afatmesme buxhetore KAB komunale paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB Komunale do paraqiten shpjegimet e politikave–prioriteteve të tanishme dhe afatmesme të Junikut si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitin 2016-2018.

2. Situata aktuale dhe analiza Hapësirave të Hapura Publike

2.1 Gjendja e tanishme e HHP

Rezultatet e këtij inventarizimi detaj janë paraqitur ne hartat tematike te krijuara ne QGIS si dhe ne forme tabelore (aneksi II dhe ai III i këtij dokumenti), te punuara gjatë sesioneve të rregullta me konsulentët të programit DEMOS. Në të njëjtat janë paraqitur HP me atributet sipas tipologjisë, madhësisë, kualitetit, si dhe sipas frekuentimit nga ana e qytetareve.

Numri i banorëve që ndërlidhet me pjesën e frekuentuar të HHP me ato të identifikuar me softuer-in Q GIS është rreth 6083 banorë. Ndërsa sipërfaqja e HHP është :

Emërtimi	Njësia në m ²
Parqe (m ²)	224680
Sheshi (m ²)	107
Kompleksi i Varrezave (m ²)	8100
Parkingu (m ²)	706

Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP

Nga inventarizimi i përmendur, për të pasur idenë për sipërfaqet aktuale te HP për qytetaret e Junikut, janë marre të dhëna mbi sipërfaqet e HP për koke banori të cilat janë treguar në tabelën më poshtë:

Tab. 1 Sipërfaqet aktuale e HHP ne qytetin e Junikut

a) Sipërfaqe për rekreacion pasiv dhe aktiv

HP sipas tipologjisë	Sipërfaqja ne ha (m ²)	Nr. i banoreve	Sip e HP ne m ² / ban.
Parqe / Gjellbërime	224680	6078	36.97
Gjithsejt HP ne m ²	224680	6083	36.97

b) Sipërfaqe të ndërtuara dhe të tjera

HP sipas tipologjisë	Sipërfaqja ne ha (m ²)	Nr. i banoreve	Sip e HP / ban.
Parkingje	706	6078	0.11
Varreza	8100	6078	1.33
Gjithsejtë HP ne m ²	233486	6078	38.41

Sipërfaqet e tanishme të HHP në Komunën e Junikut


Të dhënat themelore për HP (parqe dhe rekreacion):

- Sipërfaqja aktuale e HP për rekreacion aktiv dhe pasiv, **37.74 m²/ban** (tab. 1).
- Sipërfaqet e tanishme në aspektin e qasjes, me fokus ne largësinë (distançë – kohë):
- Ndërlidhja e HP me korridore të gjelberta, shtigje, etj.; Ne këtë moment, mund të pohohet se vërtetë HHP janë të mjaftueshme por jo me mbulueshmëri të duhur dhe jo të ndërlidhura mire, mirëpo është synim i Komunës së Junikut që në një plan afatgjatë të ofrojë të njëjtat në një nivel standard të dëshirueshëm.

Standardet e synuara/ të parapara në planet komunale janë adaptuar edhe në PMHP; Qeveria komunale synon të ofrojë HP për rekreacion aktiv dhe pasiv në numër dhe sasi të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e qytetarëve me përmbajtje natyrore, sheshe, shtigje, hapësira të tjera të shpërndara në aspektin hapësinor ashtu që të jenë afër qytetarëve. Standardi i synuar kuantitativ i HHP në plan afatgjatë është mbajtja e sipërfaqeve të Hapura Publike ekzistuese dhe krijimi i sipërfaqeve të reja, në veçanti në zonën rurale.

Kualiteti i HHP

Standardet kualitative / HHP kualitative promovojnë ruajtjen e shëndetit fizik dhe mendor. Mundësia për aktivitete fizike, qofshin ato aktive apo pasive, për pjesëmarrësit do të jetë e dobishme si në aspektin fizik, shoqëror dhe psikologjik, duke rezultuar në reduktim të tensionit, stresit të përditshëm, në promovimin e jetës së shëndoshe të qytetarëve si dhe në stabilitetin e lagjeve.



Është vlerësim i përgjithshëm se në mungesë të një plani adekuat por edhe të kapaciteteve buxhetore të kufizuara, HHP në të kaluarën nuk janë mirëmbajtur në nivel të duhur.

Shfrytëzimi i HHP

Sipas përdorimit, HP ne përgjithësi janë klasifikuar ne ato me përdorim te shpeshte, mesatar, dhe HP te cilat nuk përdoren fare.

Nr	Emri	Sipërfaqja (m ²)	Kategoria	Frekuenca e përdorimit	Përdoruesit	St. pronësor
1	Parku para Komunës	1500	Park	E mesme	E përzier	Pronë komunale
2	Parku Moronica	217358	Park	E mesme	E përzier	Pronë nën menaxhimin e AKP-së
3	Parku përgjatë lumit Erenik	9100	Park	E lartë	E përzier	Pronë publike nën menaxhimin e MMPH-së
4	Qendra	107	Hapsir gjel.	E lartë	E përzier	Pronë komunale
5	Parkingu mbrapa Komunës	706	Parking	E lartë	E përzier	Pronë komunale
6	Varrezat	8100	Varreza	E mesme	E përzier	Pronë komunale
7	Këndi i lojërave për fëmijë	920	Vend lojërash	E lartë	Fëmijët	Pronë publike nën menaxhimin e MMPH-së

2.2 Kontratat aktuale për menaxhimin e HHP

Ne te kaluarën si edhe tani, mirëmbajtja e HP është bere me kontrata shërbimesh te dhëna operatoreve te kontraktuar nga jashtë, gjegjësisht, kontrata kornize me afat trevjeçar. Nga defektet e shumta te identifikuar ne to mund te përmenden:

- a) mangësi ne ndarjen e **zonave/fushave** te mirëmbajtjes,
- b) mangësi ne aktivitetet te parapara te mirëmbajtjes,
- c) përshkrime jo koncize te aktiviteteve te mirëmbajtjes,
- d) mungese e specifikimeve teknike,

e) mangësi ne planifikim dhe ne dinamiken te mirëmbajtjes, etj.

Mangësitë e përmendura me larte kane vu ne pyetje edhe relevancen e çmimeve te ofertuar ne kontratat e mëhershme, ndërsa si pasoje edhe monitorimi i mirëmbajtjes ka mundur te jete i vështirësuar.

2.3 Shpenzimet operative për mirembajtjen e HP në tre vitet e kaluara

Nga analiza e kontratave te mehershme, te dhena mbi çmimet njesi per mirembajtjen e HP jane paraqitur ne tabelën ne vijim:

Tab. 2.a, Mirembajtja e HP ne periudhen 2012-2013

HHP sipas tipologjise	Njesia / m ²	Çmimi njesi mes. €/m ²	Çmimi i miremb. se HHP
Parqe / gjelberime	N/A		9,800.00 €
Parkingje	706		
Sheshe	107		
Tregje	N/A		
Varreza	N/A		
Gjithesejt per miremb. e HP			

Tab. 2.b, Mirembajtja e HHP ne periudhen 2014-2015


HHP sipas tipologjise	Njesia / m ²	Çmimi njesi mes. €/m ²	Çmimi i miremb. se HHP
Parqe / gjelberime	228878		12,560.00 €
Parkingje	706		
Sheshe	107		
Varreza	N/A		
Gjithesejt per miremb. e HHP			

Tab. 2.c, Mirëmbajtja e HHP në periudhën 2016-2017 (e adaptuar sipas vlerësimit(estimimit) të aktiviteteve)

HP sipas tipologjise	Njesia / m ²	Çmimi njesi mes. €/m ²	Çmimi i miremb. se HHP
Parqe / gjelberime	228878		27,267.79 €
Parkingje	706		
Sheshe	107		
Varreza	8100		
Gjithesejt per miremb. e HHP	237791		

2.4 Te dhëna grafike dhe tabelore mbi HHP ekzistuese

a) Të dhënat grafike



b).Të dhënat tabelore

Nr	Parqet(Emri ose kodi)	Sip. ne m ²	Estimimi (vjetor) Totali i shpenz. për mirëmbajtje	Kostoja(vjetore) Çmimi ne €/m ²
1	Parku para Komunes	1500	709.78 €	0.47 €
2	Parku Moronica	217358	11746.43 €	0.05 €

3	Parku pergjate lumit Erenik	9100	5474.40 €	0.60 €
4	Vendloja per femije	920	401.20 €	0.44 €
		228878	18331.81 €	0.39 (0.50)€

Nr	Sheshi dhe Parkingu	Sip. ne m ²	Totali i shpenz. për mirëmbajtje	Çmimi ne €/m ²
1	Qendra	107	150 €	1.40 €
2	Parkingu prapa obj.komunes	706	585.98 €	0.83 €
		813	735.98 €	1.12 €

Nr	Varrezat(Emri ose kodi)	Sip. ne m ²	Totali i shpenz. për mirëmbajtje	Çmimi ne €/m ²
1	Varrezat e Reja	8100	8200.00 €	1.10 €
		8100	8200.00 €	1.10 €

2.5 Analiza e aktiviteteve te mirëmbajtjes për fushat e mirëmbajtjes

a. Aktivitetet e pastrimit përfshijnë aktivitetet ne grumbullimin dhe largimin e mbeturinave, grumbullimin e gjetheve , pastrimin e kanaleve te kullimit, pastrimin e grafiteve, pastrimin e shtigjeve, fontanave etj

b. Aktivitetet e hortikultures pershfijne aktivitetet e ujitjes, kositjes, mbjelljes, pleherimi, ajrosjen, mirëmbajtjes se gjelberimit te ultë, gjelbërimit të mesëm dhe te lartë, dezinfektimit etj

c. Aktivitetet e mirëmbajtjes e ambientit të ndërtuar në kuader të hapisirave të hapisirave publike siq janë: mirembajtja e shtigjeve, mobilerise urbane, kendit të lojrave, fontanave, sistemit te ujitjes, mirëmbajtja e përmendoreve, mirëmbajtja e ndriqimit etj.

3. Vizioni, Objektivat dhe Strategjia mbi HP

3.1 Vizioni i komunës mbi HHP

Deklarata e vizionit për komunën e Junikut nga PZHK

" Komunë me administrate efikase, shërbime cilësore në arsim dhe shëndetësi, **hapësira rekreative**, ndërtime të planifikuara, **zhvillim të qëndrueshëm mjedisor, përkujdesje ndaj trashëgimisë natyrore dhe kulturore**, zhvillim ekonomik te balancuar me bujqësi të avancuar, kushte të mira për investitorët - bizneset dhe infrastrukturë bashkëkohore"

" Komuna që ofron Hapësira të Hapura Publike të sigurta, të qëndrueshme dhe tërheqëse për qytetarët".

3.2 Synimet dhe objektivat

Synimi 1 : Rigjallërimi i hapësirave ekzistuese

Objektivi: Rigjallërimi i 20000 m² te HHP ekzistuese deri ne vitin 2020.

Synimi 2: Krijimi i hapësirave te reja te HHP ne zonën rurale

Objektivi1: Krijimi i 8000 m² te HHP te reja deri ne vitin 2020

Synimi 3: Promovimi i HHP

Objektivi 1: Sensibilizimi i komunitetit për mirëmbajtjen e HHP përgjatë periudhës afatmesme (2016-2020).

4. Plani financiar

4.1 Buxheti i nevojshëm(përsëritës)

Te shtohet analiza e mirëmbajtjes se HHP dhe krijimin e HHP te reja (ekspertët financiar)

Dokumentet nga Komuna për PLANI FINANCIAR PËR MIRËMBAJTJEN E HAPËSIRAVE TË HAPURA PUBLIKE 2016 - 2020 dhe planin Investiv.

Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Gjithsej vlere në €
27267.79 €					

5. Ndërgjegjësimi publik

5.1 Strategjia komunale për aktivitetet me komunitetin

Ndërgjegjësimi publik për mjedisin ka për qëllim të ndihmojë grupet e ndryshme shoqërore gjithashtu edhe individëve të përfitojnë njohuri themelore për mjedisin dhe rëndësinë e mjedisit. Përmirësimi i mirëmbajtjes së mjedisit kërkon ndërgjegjësim mjedisor të vazhdueshëm nëpër të gjitha nivelet arsimore, duke filluar nga niveli i shkollës fillore. Strategjia e Komunës së Junikut bazohet në tri shtylla:

1. Ndërgjegjësimi për mjedisin nëpërmjet edukimit

Drejtoria për shërbime publike ne bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim do te organizon ligjërata periodike si në vijim:

- a. Ligjërata/Prezantime për nxënësit e Shkollave Fillore me qëllim përfitimit të njohurive elementare për çështjet dhe problemet mjedisore, fokusuar në ofrimin e informatave për HHP në komunën e Junikut dhe mirëmbajtjen e tyre.
- b. Ligjërata/Prezantime për nxënësit e Shkollave të Mesme me qëllim të kuptuarit e problemeve mjedisore dhe zhvillimin e aftësive për trajtimin e problemeve mjedisore

2. Ndërgjegjësimi nëpërmjet fushatave mediale

Mediet mund të luajnë rol vital në ndërgjegjësimin për mjedisin, nëpërmjet programeve për mjedisin, intervistave me akterët respektiv, prezantimeve, njoftimeve për aktivitetet e mirëmbajtjes etj.

Aktivitetet të organizuara për mirëmbajtjen e HHP duhet t'i paraprijë një fushatë mediale duke ftuar qytetarët që kontribuojnë në mirëmbajtjen e hapësirave të HHP me fokus në aktivitetet e pastrimit dhe aktivitetet e hortikulturës. Përgjegjës për organizimin e fushatave mediale është Drejtoria për Shërbime Publike përmes zyrës për informim.

3. Ndërgjegjësimi nëpërmjet kampanjave

Në kuadër të aktivitetet për mirëmbajtjen e hapësirave Publike duhet të përfshihen të gjithë akterët që mund të kontribuojnë në mirëmbajtjen e mjedisit. Organizatat joqeveritare të cilat merren me mbrojtjen e ambientit janë me rëndësi për informimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit në aktivitetet e mirëmbajtjes.

Gatishmëria e OJQ-ve dhe ndarja e aktivitetet duhet të kuptohet pas takimeve që Drejtoria për Shërbime Publike do të organizon. OJQ-të duhet të luajnë rol aktiv në monitorimin e Komunës, respektivisht drejtorisë përkatëse për aktivitet e ndryshme, në efektshmërinë dhe kualitetin e mirëmbajtjes së HHP.

Udhëheqësit lokal dhe përfaqësuesit e lokaliteteve do të ftohen të organizojnë aksione për mirëmbajtjen e HHP pranë lokaliteteve të tyre dhe Drejtoria do të përkrahë organizime të kësaj natyre.

Aktivitetet

Fillimi i sezonës pranverore shënon edhe intensifikimin e aktivitetet të mirëmbajtjes respektivisht aktivitetet të pastrimit dhe aktivitetet të hortikulturës. Aktivitete pranverore koncentrohet si në vijim:

- Pastrimi dhe rregullimi i sipërfaqeve të gjelbëruara
- Mbjellja e fidaneve

Stimulimi i "Lokalitetit më të mirëmbajtur"

Organizimi i vëzhgimit dhe ndarja e shpërblimeve adekuate për:

- Lokalitetin më mirëmbajtur
- Lagjen më të mirëmbajtur
- Parterin më të mirëmbajtur
-

6. Monitorimi dhe rishikimi

Komuna e Junikut, respektivisht Drejtoria për Shërbime Publike **do të cakton zyrtarin në përgjegjësi të së cilit do të jetë koordinimi i punëve si dhe "monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të PMHP , projekteve dhe aktiviteteve në përputhshmëri me planin e aprovuar.**

Monitorimi dhe vlerësimi do të zhvillohet duke përcjellë procedurat si në vijim:

1. Përcaktimi i aspekteve të zbatimit të projektit të cilat duhet të monitorohen nga zyrtari përgjegjës.
2. Dizajnimi i formularëve për regjistrimin e të dhënave me qëllim të vlerësimit të progresit të zbatimit të projektit.
3. Mbledhja e të dhënave nga vizitat e zhvilluara në HHP, intervistimi i akterëve në zbatimin e projektit dhe ekzaminimi i raporteve.
4. Identifikimi i shkaqeve në rast të vonësve eventuale në zbatimin e projektit dhe analizimi i materialeve të përdorura për zbatimin e projektit.
5. Dorëzimi i raporteve me të gjeturat tek institucionin respektiv duke identifikuar problemet dhe caktimi i periudhës kohore për përmirësimet.
6. Vizitat e vazhdueshme në terren dhe vërtetimi se defektet janë përmirësuar.
7. Vlerësimi i projekteve të zbatuara dhe analizimi i efekteve tek komuniteti dhe përfituesit. Rezultatet e vlerësimit mund të shfrytëzohen në formulimin e politikave për Menaxhimin e HHP.

Plotësimi dhe revidimi i PMHHP

Plotësimi i planit i referohet ndryshimeve minore në plan dhe mund të bëhet me vendim të **Zyrës së Kryetarit**, gjersa revidimi i planit i referohet ndryshimeve të mëdha të planit si pasojë e ndryshimeve thelbësore të qëllimeve dhe të objektivave të planit. Revidimi i planit kërkon proces të njëjtë sikur se gjatë përpilimit të tij.

a) Disa nga fushat të cilat janë subjekt për plotësim

Ndryshime minore në Objektiva, Strategji dhe Politika (standarde të ofrimit të shërbimeve etj),

b) Hapat të cilat duhet ndjekur për plotësimin e planit

- i. Përgatitja e propozimit për plotësimin e planit. I njëjti mund të përgatitet nga zyrtari përgjegjës për monitorimin e PMHP, Qytetarët etj.

- ii. Drejtoria për Shërbime Publike analizon propozimit dhe implikimet e përgjithshme në plan dhe përgatit një raport të cilin e dërgon tek Komiteti për Planifikim. Raporti përbehet nga:
- Natyra e plotësimit të PMHP
 - Qëllimi i plotësimit të PMHP
 - Specifikimi i pjesës së planit ku kërkohet plotësimi
 - Arsyetimi i plotësimit të planit
 - Politikatat e propozuara

		Formulari i afatit kohor për monitorimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes																																											
		Janar				Shkurt				Mars				Prill				Qershor				Korrik				Gusht				Shtator				Tetor				Nentor				Dhjetor			
		Kodi	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4			
AP	Grumbullimi i gjetheve																																												
AP	Pastrimi i kanaleve te kullimit																																												
AP	Pastrimi i grafiteve																																												
